

### Tabelat – ushtrime për zgjidhje

**Ushtrimi 1:** Në vektorin NOTAT(N) jepen notat e studentëve të një grupi në lëndën e informatikës. Të ndërtohet një program që gjen se cila është nota më e lartë që ka marrë ky grup dhe sa të tilla janë. Gjetja e maksimumit.

**Ushtrimi 2:** Të ndërtohet një program, për një vektor të dhënë  $V(N)$ , i cili i kërkon përdoruesit të fusë  $n$  numra të plotë dhe gjen vlerën më të madhe dhe pozicionin e tij në vektor (nëse ka më shumë se një maksimum gjen të fundit). Gjetja e maksimumit me operatorin e krahasimit  $\geq$ . Për pozicionin merrni  $\text{imax}=i$ .

**Ushtrimi 3:** Të ndërtohet një program që gjen vlerën minimale dhe pozicionin e tij në vektorin  $V(N)$ . (nëse ka më shumë se një minimum gjen të parin). Gjetja e minimumit me operatorin e krahasimit  $<$ . Për pozicionin merrni  $\text{imin}=i$ .

**Ushtrimi 4:** Jepet një vektor  $A(N)$ . Të ndërtohet një program, i cili afishon të gjithë ata elementë të vektorit që plotësojnë kushtin  $A[i] = i$ . Në rast se nuk ka elementë të tillë të afishohet mesazhi "Këta elementë nuk ekzistojnë".

**Ushtrimi 5: (zgjidhur)** Jepet një vektor  $V(N)$  me numra reale. Të ndërtohet një program që të zgjidhë këto detyra: a) të gjejë mesataren  $MA$  të elementëve të vektorit;  
b) të kontrollojë nëse ekziston në vektor një numër që të jetë i barabartë me mesataren e tij; nëse po, të jepet pozicioni.

'Ushtrimi 5 Jepet një vektor  $V(N)$  me numra reale. Të ndërtohet një program që të zgjidhë këto detyra:

'a) të gjejë mesataren MA të elementëve të vektorit;

'b) të kontrollojë nëse ekziston në vektor një numër që të jetë i barabartë me mesataren e tij; nëse po, të jepet pozicioni.

**Sub ushtrimi5()**

Dim V(1 To 10) As Double 'N=10

Dim i As Integer

Dim shuma As Double

Dim MA As Double

Dim Poz\_MA As Integer

V(1) = 1.4

V(2) = 2.3

V(3) = 4.1

V(4) = 3.6

V(5) = 6.2

V(6) = 3.6

V(7) = 7.8

V(8) = 3.5

V(9) = 2.9

V(10) = 5.6

shuma = 0#

For i = 1 To 10 shuma

= shuma + V(i)

Next i

MA = shuma / 10

MsgBox "Mesatarja=" & MA

Poz\_MA = 0

For i = 1 To 10

If MA = V(i) Then

Poz\_MA = i

MsgBox "Elemente=MA eshte ne pozicionin: " & Poz\_MA

End If

Next i

End Sub